

**Dhënia e Informacioneve Shpjeguese-  
Transferimi i Aktiveve Financiare**  
(Amendime të SNRF 7)

## Amendime të SNRF 7 Instrumentat Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

### Transferimi i aktiveve financiare

- 42A Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 42B–42H të SNRF 7 që lidhen me transferimin e aktiveve financiare shtojnë kërkesa të tjera për dhënie informacionesh shpjeguese të këtij SNRF. Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 42B–42H në një shënim shpejgues të vetëm të pasqyrave të saj financiare. Një njësi ekonomike duhet të sigurojë dhënien e kërkuar të informacioneve shpjeguese për të gjitha aktivet financiare të transferuara që nuk janë ç’regjistruar si dhe për çdo përfshirje të vazhdueshme në një aktiv të transferuar, që ekziston në datën e raportimit, pavarësisht se kur ka ndodhur veprimi përkatës i transferimit. Me qëllim zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në këto paragrafë, një njësi ekonomike transferon të gjithë ose një pjesë të aktivit financiar (aktivit financiar të transferuar), nëse dhe vetëm nëse, ajo:
- (a) transferon të drejtat kontraktuale për të marrë flukse mjetesh monetare të atij aktivit financiar; ose
  - (b) mban të drejtat kontraktuale për të marrë flukse mjetesh monetare të atij aktivit financiar, por merr përsipër (njeh) një detyrim kontraktual për të paguar flukse mjetesh monetare tek një ose më shumë palë të tjera në një marrëveshje.
- 42B Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese që i mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare:
- (a) të kuptojnë lidhjen midis aktiveve financiare të transferuara të cilat nuk janë ç’regjistruar në tërësinë e tyre dhe detyrimeve të lidhura me to; dhe
  - (b) të vlerësojnë natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë përfshirjen e vazhdueshme të njësisë ekonomike në aktivet e ç’regjistruara financiare.
- 42C Me qëllim zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 42E–42H, një njësi ekonomike ka përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar nëse, si pjesë e transferimit, njësi ekonomike mban ndonjë nga të drejtat ose detyrimet kontraktuale të lidhura me aktivin financiar të transferuar ose merr ndonjë të drejtë të re ose detyrim të ri që lidhet

me aktivin financiar të transferuar. Me qëllim zbatimin e kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 42E–42H, elementët e mëposhtëm nuk përbëjnë përfshirje të vazhdueshme:

- (a) Paraqitjet normale dhe garancitë që lidhen me transferimin mashtrues dhe konceptet e arsyeshmërisë, mirëbesimit dhe marrëveshjeve të singërta që mund të shfuqizojnë një transferim si rezultat i një veprimi ligjor;
- (b) Kontratat e së ardhmes, opsionet dhe kontrata të tjera për të riblerë aktivin financiar të transferuar për të cilin çmimi i kontratës (ose çmimi i ushtrimit të opsionit) është vlera e drejtë e aktivit financiar të transferuar; ose
- (c) Një marrëveshje sipas së cilës një njësi ekonomike mban të drejtat kontraktuale për të marrë flukse mjetesh monetare të një aktivi financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual për të paguar flukse mjetesh monetare tek një ose më shumë njësi ekonomike dhe plotësohen kushtet e paragrafëve 19(a)–(c) të SNK 39.

## **Aktivitet financiar të transferuara që nuk janë çregjistruar në tërësinë e tyre**

42D Një njësi ekonomike mund të ketë transferuar aktive financiare në një mënyrë të tillë që pjesë ose të gjitha aktivitet financiar të transferuara nuk kualifikohen për çregjistrim. Për të plotësuar objektivat e vendosura në paragrafët 42B(a), njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në çdo datë raportimi për çdo klasë të aktiveve financiare të transferuara që nuk janë çregjistruar në tërësinë e tyre për:

- (a) natyrën e aktiveve të transferuara.
- (b) natyrën e rreziqeve dhe përfitimeve që lidhen me titullin e pronësisë së aktiveve të transferuara dhe që ndaj të cilave është e ekspozuar njësi ekonomike.
- (c) një përshkrim të natyrës së marrëdhënieve midis aktiveve të transferuara dhe detyrimeve të lidhura me to, duke përfshirë kufizimet që vijnë nga transferimi në përdorim i aktiveve të transferuara për njësinë ekonomike raportuese.
- (d) kur pala tjetër (palët e tjera) që lidhet me detyrimet ka të drejtë vetëm ndaj aktiveve të transferuara, një pasqyrë që tregon llogaritjet e vlerës së drejtë të aktiveve të transferuara, të vlerës së drejtë të detyrimeve që lidhen me to dhe të pozicionit neto (diferenca midis vlerës së drejtë të aktiveve të transferuara dhe detyrimeve të lidhura me to).

- (e) kur njësia ekonomike vazhdon të njohë të gjitha aktivet e transferuara, vlerën kontabël të aktiveve të transferuara dhe të detyrimeve të lidhura me to.
- (f) kur njësia ekonomike vazhdon të njohë aktivet në nivelin e përfshirjes së saj të vazhdueshme (shiko paragrafët 20(c)(ii) dhe 30 të SNK 39), vlerën totale kontabël të aktiveve origjinale para transferimit, vlerën kontabël të aktiveve që njësia ekonomike vazhdon të njohë, dhe vlerën kontabël të detyrimeve që lidhen me to.

## **Aktivitet financiarë të transferuara që janë ç’regjistruar në tërësinë e tyre**

42E Për të arritur objektivat e vendosura në paragrafin 42B(b), kur një njësi ekonomike ç’regjistron aktivitet financiarë të transferuara në tërësinë e tyre (shiko paragrafët 20(a) dhe (c)(i) të SNK 39) por ka përfshirje të vazhdueshme në to, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për çdo lloj të përfshirjes së vazhdueshme në çdo datë raportimi, minimumi për:

- (a) vlerën kontabël të mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që janë njohur në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike dhe përfaqësojnë përfshirjen e vazhdueshme të saj në aktivet e ç’regjistruara financiare, dhe pozicionet (zërat e pasqyrës) në të cilat vlera kontabël e këtyre aktiveve dhe detyrimeve është njohur.
- (b) vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve që përfaqësojnë përfshirjen e vazhdueshme të njësisë ekonomike në aktivet e ç’regjistruara financiare.
- (c) vlerën që përfaqëson më mirë ekspozimin maksimal të njësisë ekonomike ndaj humbjes nga përfshirja e vazhdueshme në aktivet financiare të ç’regjistruara, dhe informacionin që tregon se si përcaktohet ky ekspozim.
- (d) flukset dalëse të mjeteve monetare të paskontuara që mund të kërkohen ose do të kërkoheshin për të riblerë aktivitet financiarë të ç’regjistruara (p.sh. çmimi i përcaktuar në një marëveshje opsioni) ose shumat e tjera të pagueshme për palën ku janë transferuar aktivitet. Nëse flukset dalëse të mjeteve monetare janë variabël atëherë shumat e paraqitura në informacionet shpjeguese duhet të bazohen në kushtet që ekzistojnë në çdo datë bilanci.
- (e) Një analizë të afatit të maturimit të flukseve dalëse të mjeteve monetare të paskontuara që mund të kërkohen ose do të kërkoheshin për të riblerë aktivitet financiarë të ç’regjistruara ose

të shumave të tjera të pagueshme për palën ku janë transferuar aktivet, duke treguar afatet kontraktuale të mbetura deri në maturim të përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike.

- (f) informacionin cilësor që shpjegon dhe mbështet dhënien e informacioneve shpjeguese sasiore të kërkuara në (a)–(e).

42F Një njësi ekonomike mund të bashkojë informacionin e kërkuar nga paragrafi 42E në lidhje me një aktiv të veçantë nëse njësi ekonomike ka më shumë se një lloj të përfshirjes së vazhdueshme në atë aktiv financiar të ç’regjistruar dhe e raporton atë sipas një lloji të përfshirjes së vazhdueshme.

42G Gjithashtu, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për çdo lloj të përfshirjes së vazhdueshme për:

- (a) fitimin ose humbjen e njohur në datën e transferimit të aktiveve.
- (b) të ardhurat dhe shpenzimet e njohura në periudhën raportuese dhe të akumuluar, nga përfshirja e vazhdueshme në aktivet financiare të ç’regjistruara (p.sh. ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve).
- (c) nëse vlera totale e shumave të arkëtuara nga aktiviteti i transferimit (që kualifikohen për ç’regjistrim) në një periudhë raportuese nuk është shpërndarë ende përgjatë periudhës, (p.sh. nëse një pjesë e konsiderueshme e vlerës totale nga aktiviteti i transferimit është arkëtuar ditët e fundit të periudhës raportuese):
- (i) kur aktiviteti më i madh i transferimit ka ndodhur brenda asaj periudhe raportuese (p.sh. pesë ditë para fundit të periudhës raportuese),
- (ii) shumat (p.sh. fitimet ose humbjet përkatëse) e njohura nga aktiviteti i transferimit në atë pjesë të periudhës raportuese, dhe
- (iii) vlerën totale të arkëtimeve nga aktiviteti i transferimit në atë pjesë të periudhës raportuese.

Një njësi ekonomike duhet ta japë këtë informacion për çdo periudhë për të cilën paraqitet një pasqyrë përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## Informacion shtesë

42H Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për çdo informacion shtesë që ajo e konsideron të nevojshëm për të plotësuar objektivat në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese në paragrafin 42B.

## **Data efektive dhe periudha kalimtare**

---

Shtohet paragrafi 44M.

- 44M *Dhënia e informacioneve shpjeguese — Transferimi i aktiveve financiare* (Amendime të SNRF 7), publikuar në Tetor 2010 hoqi paragrafin 13 dhe shtoi paragrafët 42A–42H dhe B29–B39. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto amendime për periudhat ushtrimore që fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2011. Lejohet zbatimi më i hershëm i këtyre amendimeve. Nëse një njësi ekonomike zbaton amendimet në një datë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt. Një njësi ekonomike nuk ka nevojë të japë informacione shpjeguese të kërkuara nga këto amendime për çdo periudhë që fillon përpara datës së zbatimit fillestar të amendimeve.

## Shtojca B

### Udhëzime për zbatim

Pas paragrafit B28, shtohen nëntitujt dhe paragrafët B29–B39.

### Ç'regjistrimi (paragrafët 42C–42H)

#### **Përfshirja e vazhdueshme (paragrafi 42C)**

- B29 Vlerësimi i përfshirjes së vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar sipas kërkesave për dhënie e informacioneve shpjeguese në paragrafët 42E–42H bëhet në nivel të njësisë ekonomike raportuese. Për shembull, nëse një njësi e kontrolluar (filial) transferon tek një palë e tretë e palidhur, një aktiv financiar në të cilin njësia kontrolluese (mema) ka përfshirje të vazhdueshme, njësia e kontrolluar (filiale) nuk e merr parasysht përfshirjen e njësisë kontrolluese (memes) në vlerësimin nëse vetë ajo ka përfshirje të vazhdueshme në aktivin e transferuar në pasqyrat e saj financiare individuale (p.sh. kur njësia e kontrolluar (filiale) është njësi raportuese). Megjithatë, një njësi kontrolluese (memë) do ta merrte parasysht përfshirjen e saj të vazhdueshme (ose përfshirjen e vazhdueshme të ndonjë njësie tjetër brenda grupit) në një aktiv financiar të transferuar nga njësia e kontrolluar prej saj në përcaktimin nëse ajo ka përfshirje të vazhdueshme në aktivin e transferuar në pasqyrat financiare të konsoliduara (p.sh. kur njësia raportuese është grupi).
- B30 Një njësi ekonomike nuk ka një përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar, nëse, si pjesë e transferimit, ajo as nuk mban ndonjë nga të drejtat ose detyrimet kontraktuale të lidhura me aktivin financiar të transferuar, as nuk blen të drejta apo detyrime kontraktuale të reja që lidhen me aktivin financiar të transferuar. Një njësi ekonomike nuk ka përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar, nëse ajo nuk ka as interes në performancën e ardhshme të aktivit financiar të transferuar, as përgjegjësi në ndonjë rrethanë për të bërë pagesa në të ardhmen në lidhje me aktivin financiar të transferuar.
- B31 Përfshirja e vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar mund të lindë nga parashikimet kontraktuale në marrëveshjen e transferimit ose në një marrëveshje të veçantë me palën ku është bërë transferimi ose me një palë të tretë që ka hyrë në aktivitetin e transferimit.

## **Aktivet financiare të transferuara që nuk janë ç’regjistruar në tërësinë e tyre**

- B32 Paragrafi 42D kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese kur pjesë ose të gjitha aktivet financiare të transferuara nuk kualifikohen për ç’regjistrim. Këto informacione shpjeguese kërkojnë në çdo datë raportimi në të cilat njësi ekonomike vazhdon të njohë aktivet financiare të transferuara, pavarësisht kur ka ndodhur transferimi.

## **Llojet e përfshirjes së vazhdueshme (paragrafët 42E–42H)**

- B33 Paragrafët 42E–42H kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasiore për çdo lloj të përfshirjes së vazhdueshme në aktivet financiare të ç’regjistruara. Një njësi ekonomike duhet t'i bashkojë përfshirjet e saj të vazhdueshme në lloje që janë përfaqësues të ekspozimeve të njësisë ekonomike ndaj rreziqeve. Për shembull, një njësi ekonomike mund t'i bashkojë përfshirjet e saj të vazhdueshme sipas llojit të instrumentit financiar (p.sh. garancitë ose opsionet për blerje) ose sipas llojit të transferimit (p.sh. shitja e llogarive të arkëtueshme-factoringu, përgatitja e letrave me vlerë për tregëtim dhe huazimi i letrave me vlerë).

## **Analiza e maturimit të flukseve dalëse të mjeteve monetare të paskontuara për të riblerë aktivet e transferuara (paragrafi 42E(e))**

- B34 Paragrafi 42E(e) kërkon që një njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese për një analizë maturimi të flukseve dalëse të mjeteve monetare të paskontuara për të riblerë aktivet financiare të ç’regjistruara ose të shumave të tjera të pagueshme për palën ku është bërë transferimi i aktiveve financiare të ç’regjistruara, duke treguar afatet kontraktuale të mbetura deri në maturim të përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike. Kjo analizë dallon flukset e mjeteve monetare që kërkohet të paguhen (p.sh. kontratat e së ardhmes), flukset e mjeteve monetare që njësi ekonomike mund të kërkohet të paguajë (p.sh. opsionet e nënshkruara për shitje) dhe flukset e mjeteve monetare që njësi ekonomike mund të zgjedhë për të paguar (p.sh. opsionet e blera për blerje).
- B35 Një njësi ekonomike duhet të përdorë gjykimin e saj për të përcaktuar një numër të përshtatshëm të hapësirave kohore kur përgatit analizën e afatit të maturimit kërkuar nga paragrafi 42E(e). Për shembull një njësi ekonomike mund të përcaktojë se hapësirat e mëposhtme të afateve të maturimit janë të përshtatshme:

- (a) deri në një muaj;
- (b) nga një deri në tre muaj;
- (c) nga tre deri në gjashtë muaj;
- (d) nga gjashtë muaj deri në një vit;
- (e) nga një deri në tre vjet;
- (f) nga tre deri në pesë vjet; dhe
- (g) më shumë se pesë vjet.

B36 Nëse ka një diapazon të afateve të mundshme të maturimit, flukset e mjeteve monetare përfshihen (grupohen) në bazë të datës më të hershme në të cilën njësia ekonomike mund të kërkohet ose lejohet të paguajë.

### Informacioni cilësor (paragrafi 42E(f))

B37 Informacioni cilësor i kërkuar nga paragrafi 42E(f) përfshin një përshkrim të aktiveve financiare të ç’regjistruara si dhe natyrën dhe qëllimin e përfshirjes që vazhdon të mbahet edhe pas transferimit të këtyre aktiveve. Ai përfshin gjithashtu një përshkrim të rreziqeve ndaj të cilave një njësi ekonomike është e ekspozuar, duke përfshirë:

- (a) një përshkrim se si e administron njësia ekonomike rrezikun e vetvetishëm në përfshirjen e saj të vazhdueshme në aktivet financiare të ç’regjistruara.
- (b) nëse njësia ekonomike kërkohet t’i mbartë humbjet përpara palëve të tjera, renditjen dhe shumat e humbjeve që vijnë nga palët e interesit të cilave renditet më poshtë se interesit i njësisë ekonomike mbi aktivin (p.sh. përfshirja e saj e vazhdueshme mbi aktivin).
- (c) një përshkrim të çdo mekanizmi të lidhur me detyrimet për të siguruar mbështetje financiare ose për të riblerë një aktiv financiar të transferuar.

### Fitimet ose humbjet nga ç’regjistrimi (paragrafi 42G(a))

B38 Paragrafi 42G(a) kërkon që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për fitimet ose humbjet nga ç’regjistrimi i aktiveve financiare në të cilat njësia ekonomike ka përfshirje të vazhdueshme. Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues nëse një fitim ose një humbje ka lindur sepse vlera e drejtë e elementëve përbërës të aktivitetit të njohur më parë (p.sh. interesit mbi aktivin e ç’regjistruar dhe interesit i mbajtur nga njësia ekonomike) ndryshonin nga vlera e

drejtë e aktivitet të njohur më parë si një i tërë. Në këtë situatë, njësia ekonomike duhet të japë gjithashtu informacion shpjegues nëse vlerësimi i vlerës së drejtë përfshinte të dhëna të rëndësishme që nuk ishin bazuar në të dhënat e vëzhgueshme të tregut, siç përshkruhet në paragrafin 27A.

## **Informacion shtesë (paragrafi 42H)**

B39 Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 42D–42G mund të mos jetë e mjaftueshme për të plotësuar objektivat mbi dhënien e informacioneve shpjeguese në paragrafin 42B. Në këtë rast, njësia ekonomike duhet të shpjegojë çfarëdoj informacioni shtesë që është i nevojshëm për të plotësuar objektivat mbi dhënien e informacioneve shpjeguese. Njësia ekonomike duhet të vendosë, në dritën e rrethanave të saj, sa informacion shtesë ka nevojë të sigurojë për të plotësuar nevojat për informacion të përdoruesve dhe se sa theks vendos në aspektet e ndryshme të informacionit shtesë. Është e nevojshme të vendosim një balancë midis ngarkesës së pasqyrave financiare me informacion shtesë që nuk mund t'i ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare dhe fshehjes së informacionit si rezultat i shumë bashkimeve.

## Amendim i SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Shtohet paragrafi 39F

### Data efektive

- 39F *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese — Transferime të Aktiveve Financiare* (Amendime të SNRF 7), publikuar në Tetor 2010, shtoi paragrafin E4. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë amendim për periudhat ushtrimore që fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2011. Lejohet zbatimi më i hershëm i këtij amendimi. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë amendim për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt

### Shtojca E Përjashtime afat-shkurtra nga SNRF-të

Është shtuar paragrafi E4 dhe një shënim në fund të faqes.

### Dhënia e informacioneve shpjeguese për instrumentat financiarë

- E4 Një zbatues për herë të parë i SNRF mund të zbatojë dispozitën kalimtare në paragrafin 44M të SNRF 7. \*

\* Paragrafi E4 u shtua si rrjedhojë e amendimeve të SNRF 7 *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese—Transferime të Aktiveve Financiare*, publikuar në Tetor 2010. Për të shmangur përdorimin e mundshëm të perceptimeve dhe për të siguruar se zbatuesit për herë të parë nuk janë të disavantazhuar në krahasim me hartuesit sipas SNRF-ve aktuale, Bordi vendosi që zbatuesit për herë të parë të lejohen të përdorin të njëjtën dispozitë kalimtare që lejohet për hartuesit ekzistues të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me SNRF-të që

AMENDIME TË SNRF 7—TETOR 2010

janë përfshirë në *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese – Transferime të Aktiveve Financiare* (Amendime të IFRS 7)